



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRIË

Rr. "Adem Jashari" nr.1, tel.028 571343

<b>DATË/A:</b>	01.07.2021
<b>REFERENC-Ë:</b>	
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Të gjithë të interesuarit për aplikim për "Furnizim me Freze për Traktor"
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural Z. Kujtim Pllana
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Thirrje për Aplikim



Njoftohen të gjithë të interesuarit se mund të aplikojnë në thirrjen për aplikim Freze për Traktor 180cm.

**I.Aplikuesi duhet t'i plotësojë kushtet e përgjithshme si në vijim:**

1. Të jetë banorë i Komunës së Vushtrrisë;
2. Të jetë prodhues i qumështit dhe kulturave lavërtare;
3. Të posedoj traktorë adekuat për përdorim të frezes 180cm;
4. Përparësi kanë fermerët të cilët nuk kanë përfituar më herët;
5. Aplikuesi duhet të participoj në financimin e projektit nëse përzgjidhet si përfitues.

**II. Përzgjedhja e përfituesit do të bëhet duke u bazuar në kriteret e më poshtme;**

1	Kategoritë e familjeve me jetim, familjeve të dëshmorëve, martirëve, invalidë dhe veteranë.	4 pikë				
2	Fleta poseduese në emër të aplikuesit	4pikë				
4	Familjet me numër më të madh të antarëve të papunë	4 pikë	1-2an. 1 pikë	3-4an. 2 pikë	5-6an. 3 pikë	7 e më tepër 4 pikë
5	Familjet me numër të madh fëmijësh	4 pikë	1-2fëm. 1 pikë	3-4fëm. 2 pikë	5-6fëm. 3 pikë	7 e më tepër 4 pikë
7	Fermeri që posedon sipërfaqe të mbjellura sipas aplikacionit në AZHB	10 pikë	1- 4ha 10 pikë	5-6ha 8 pikë	7- 8ha 6 pikë	9 e më tepër 4 pikë
8	Fermeri që nuk ka qenë përfitues ose ka qenë përfitues sipas viteve	10pikë	Asnjher 10pikë	Vitin 2018 3 pikë	Vitin 2019 2 pikë	Vitin 2020 1 pikë
9	Kualifikimi-	4 pikë	4 pikë 2 pikë	Fakulteti-drejtimi bujqësisë Shkolla e mesme bujqësore		
10	Kapaciteti i aplikuesit për jetësimin e grantit ( vlerësimi nga terreni)	10 pikë				
	<b>Numri total i pikëve</b>	<b>50 pikë</b>				

**Dokumentet për aplikim:**

1. Aplikacioni i plotësuar;
2. Kopja e letërnjoftimit të aplikuesit;
3. Vërtetimin për kryerjen e obligimeve komunale(tatimi në pronë, mbeturinat-merret parasysh vetëm vërtetimi i aplikuesit dhe familjareve nga certifikata e bashkësisë familjare);
4. Certifikata pronësore (fleta poseduese)-kopje;
5. Certifikatën e bashkësisë familjare;
6. Dëshminë për sipërfaqet e mbjella (formulari për aplikim-pagesa direkt);
7. Dëshminë për përgatitjen profesionale(nëse posedon)-kopje;
8. Dëshmi për kategorin të familjeve me jetim,deshmorve,martirve,invalid,dhe veteranve.
9. Dëshmi mbi posedimin e traktorit.

## **Vrejtje;**

1. Gjatë procedurës së kontrollit, në rast të gjetjes së shkeljeve dhe tentimit për mashtrim do të aplikohen masa ndëshkimore duke mos i dhënë mundësi përfitimi për tre vitet e ardhshme.
2. Nëse komisioni parasheh të nevojshme sjelljen e dokumenteve shtesë, të cilat mundësojnë zgjedhjen e përfituesit, qytetari (fermeri) është i obliguar që t'i sjellë ato në afatin i cili i caktohet, në të kundërtën e humb të drejtën për të qenë përfituesi i subvencionit (grantit).
3. Aplikoacionet e pa kompletuara dhe te dorzuara pas afatit të parapare në thirrje nuk do të shqyrtohen

*Aplikohet në zyrën pritëse të Komunës.*

*Afati i fundit për aplikim: 16/07/2021 ora 15:30.*